

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 05,
paraqitur në KQZ në datën 03.03.2022"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Mema.
- **Parti Politike:** Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (A.Kaziaj)
- **Të tjerë:** Bashkia Shkodër (V.Ademi)

Z. E. Lako: Atëherë vazhdojmë me Kërkesën Ankimore nr. 5 për verifikimin e plotësisht të elementeve të formës dhe të përmbajtjes, me subjekt ankues Bashkia Shkodër, me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr.116, datë 02.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit për zgjedhjet e pjeshme vendore. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur dje, në datën 3 mars 2022, bazuar në nenin 129, të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kryetarja në detyrë e Bashkisë Shkodër. Ndonjë palë tjetër e interesuar?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Do përfaqësoj unë koalicionin, si palë e interesuar përpara këtij komisioni, me autorizim, avokat Altin Kaziaj, për koalicionin "Shtëpia e Lirisë".

Z. E. Lako: Atëherë shkurtimisht, zoti Sekretar i Përgjithshëm!

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një kërkesë ankimore nr. 5, datë 03.02.2022, ora 16:09, me ankues Bashkia Shkodër, me objekt ankimi: Kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 116, datë 02.03.2022, i cili ka shqyrtuar kërkesën e Bashkisë Shkodër, për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, të zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 mars 2022. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore, konstatohet se është në përputhje me nenin 126, si nga forma dhe nga përmbajtja, pasi në ankim përmbahet emri i plotë i ankimuesit, referohet vendimi që ankimohet, është baza ligjore, është përshkrimi i shkurtër i shkeljes së pretenduar, përshkrimi i fakteve, argumenteve, dispozitat ligjore, në të cilat mbështetet ky ankim, tregimi i provave që kërkohen të merren gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, si dhe data dhe firma e ankimuesit. Gjithashtu është në përputhje me nenin 130, të Kodit Zgjedhor. Është kompetencë e KAS-it të shqyrtojë kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është legjitimimi i ankuesit pasi legjitimohet në ngritje të kësaj padie, pasi kryetari i bashkisë është ai që cakton qendrat e votimit, dhe është respektuar afati ligjor i ankimit 24-orësh. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! Atëherë, duke pasur parasysh çfarë u tha dhe nga zoti Sekretar i Përgjithshëm, që ky shqyrtim që po bëjmë sot ka të bëjë me formën e ankimit, dhe me kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

ankimit, në bazë të neneve 124, 126, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Shkurtimisht dhe përfaqësuesit dhe ankuesit për formën dhe përmbajtjen e ankimit të bërë para KAS-it.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Atëherë ne jemi njohur në fakt me vendimin nr.116, datë 02.03.2022. E kemi vlerësuar dhe lexuar në fakt, dhe duke e verifikuar atë çfarë është shprehur nga Komisioneri, gjykojmë që arsyetimi që bën bazuar në nenet përkatëse nuk i referohet pretendimeve. Domethënë, konkluzioni që bën bazuar në nenin 62, pika 4, dhe nenin 69 pika 2 dhe 3, sigurisht dhe neni 19, pika 2, nuk je në bazë ligjore për të arritur në atë përfundim, të cilin Komisioneri ka arritur. Kështu ne kemi vlerësuar që të insistojmë në kërkesën tonë, duke e ankimuar atë dhe lidhet pikërisht me faktin që ne kemi verifikuar në territor për pamundshmërinë e vendosjes të objekteve, apo të qendrave të votimit, në objektet në të cilat Komisioneri ka miratuar si qendra votimi, në njësitë administrative Shalë, Shosh dhe Pult. Me arsyetimin, për faktin se jemi në kushtet e një shkaku madhor, për shkak të gjendjes, të infrastrukturës, kushteve atmosferike, ngricave që ekzistojnë edhe tani që flasim, dhe do të jenë edhe më shumë në datën 5 dhe 6 mars gjatë natës, por edhe gjatë ditës, dhe sigurisht aspekte të tjera që lidhen me infrastrukturën e domosdoshme për të siguruar një funksionim normal, qoftë të komisioneve zgjedhore në këto qendra, por njëkohësisht edhe për qytetarët që do të duhet të shkojnë të votojnë. Arsyeja pse unë dhe ne, Bashkia Shkodër kemi gjykuar që ta ripërsërisim kërkesën, dhe nuk janë vetëm shkresat datë 22, 24, 28, por e kemi informuar KQZ-në edhe në momentin e parë ku informojmë për qendrat e votimit, duke shënuar të gjitha aspektet që lidhen me infrastrukturën dhe një ndër ato ka qenë pikërisht dhe kushtet e vështira të motit, por njëkohësisht dhe infrastruktura, energjia e me radhë. Kemi paraqitur kërkesën pranë jush, pikërisht duke bazuar këtë arsyetim

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

në pamundshmërinë e krijuar për të gjithë zgjedhësit, për të shkuar për të votuar, duke marrë në konsideratë që ndër 5773 zgjedhës të këtyre zonave, rreth 204-205 janë, banojnë në këtë territor, të tjerët jetojnë në Shkodër, dhe do duhet të bëjnë kilometra, jo 5 mijë metra, sa thotë ligji në rastin ku bashkohen qendrat, që është niveli maksimal i lejuar për të pasur distancë nga qendra e votimit, por shkojnë në një gjatësi 60 km, në një rrugë të tmerrshme dhe të rrezikshme, e theksoj, të rrezikshme për jetën. Kjo argumentohet edhe me fakte që janë imazhe, apo foto të marra në datën 27 shkurt, por njëkohësisht unë kam marrë dhe parashikimin e motit për të verifikuar se çfarë do të ndodhë ditën, më datën 6 në mëngjes dhe kemi 100% shi në Shkodër dhe borë nëpër male. Dhe në zonat ku ka kthesa dhe nuk bie dielli, për ata që ndoshta e kanë parë, territori atje është i paaksesueshëm. Kjo do të bëjë të pamundur që të ketë mundësi qoftë edhe transporti për ata që duhet të shkojnë të votojnë, frikë, dhe e them, rrezik për jetën. Mendoj që në kushtet në të cilat është territori atje, komisionerët patjetër do të kenë probleme për të aksesuar dhe për të hapur qendrat e votimit. Patjetër qytetarëve për shkak të pamundësisë për të shkuar në qendrat e votimit, do t'u cenohet e drejta legjitime që kanë për të zgjedhur. Unë mund të verifikoj faktin që ata banojnë në Shkodër, në sajë të shërbimeve që ata marrin në Shkodër. Kështu, unë mora një informacion paraprak tani, për ata që marrin ndihmë ekonomike KEMP, apo shërbime të pagesave të paaftësisë që detyrohen të paraqiten pranë zyrave administrative në Shkodër dhe shkojnë në një numër të konsiderueshëm, rreth 600 familje që paraqiten çdo muaj, apo një herë në dy javë në zyrat e njësive administrative Shalë, Pult dhe Shosh, që jo rastësisht, jo këtë vit, por prej 6 vitesh ndodhen gjatë dimrit, në Njësinë Administrative Rrethina, dhe të gjithë banorëve u shërbehet aty sepse ata janë rezidentë në Shkodër gjatë stinës së dimrit. Lëvizja e tyre drejt njësive ku ata kanë gjendjen civile fillon pasi nuk ka borë, shkrihet bora, ne krijojmë një mundësi aksesimi atje, dhe fillon jeta në

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

male. Kështu, jo rastësisht në fakt, zgjedhjet zhvillohen gjatë periudhës pranverë-verë, pikërisht për të siguruar edhe këtë dhe mendoj që edhe në këtë aspekt është marrë në konsideratë edhe periudha zgjedhore kur përcaktohet. Por, jemi në kushtet e zgjedhjeve të tjera, të parakohshme dhe në kuadër të vakancës, dhe në këtë rast sigurisht mendoj që kjo do duhet të merret në konsideratë, sepse mund, thashë edhe njëherë, njerëzve mund t'u cenohet vërtet jeta, nuk mund të shkojnë të votojnë, mund të jetë presion pikërisht i kushteve atje për të pasur frikë dhe për t'u nisur për të shkuar për të votuar, dhe nga ana tjetër mund të kemi dhe rrezikun e moshapjes së qendrave të votimit, gjë që cenon tërësisht procesin dhe mendoj që ne nuk jemi në kushtet e komoditetit për të pasur dhe për të ripërsëritur sa herë të na teket zgjedhje. Unë kështu e kam vlerësuar si kryetare e Bashkisë Shkodër dhe mendoj që ne të gjithë, dhe Bashkia Shkodër në këtë rast, kemi detyrimin për të dhënë të gjitha opsionet për të siguruar dhe dhënë mundësinë të gjithë zgjedhësve për të votuar. Pse kemi propozuar ato qendra? Ndoshta Komisioneri mund të vendoste vendndodhje të tjera, për ne s'ka rëndësi a është privat, apo është publik. Ne në fakt kemi bërë një skanim të territorit për institucionet publike, nuk kemi pasur të tilla. Kemi disa shkolla, por ato aktualisht përdoren si qendra votimi, në Njësinë Administrative Rrethina, por edhe në lagjen nr.5 edhe 1, ku njerëzit banojnë, dhe po flas për zonën e "Fermentimit" që është ngjitur me Njësinë Administrative Rrethina. Kemi gjykuar që aty ku ata më së shumti banojnë, dhe thashë janë Rrethinat, lagjja nr.1 dhe lagjja nr.5, pikërisht në atë zonë të propozojmë territore, objekte private, për të cilat ne jemi konsultuar në fakt me përfaqësuesit politikë atje. Në bazë në fakt, të propozimit të tyre, unë e kam marrë angazhimin për t'ia propozuar Komisionerit, si një objekt i ri për të funksionuar si qendër votimi për votues të këtyre njësive administrative. Normalisht kërkesat e mia kanë qenë të ripërsëritura, propozimi për objektin që ne ia kemi dhënë si opion Komisionerit është bazuar pikërisht, në kërkesën e Partisë

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

Socialiste dhe “Shtëpisë së Lirisë”. Mund të jetë dhe një objekt tjetër, por unë nuk e shoh të mundshme që atje të zhvillohen, s’po them në standard, të zhvillohen zgjedhjet, se në standard as që bëhet fjalë.

Z. E. Lako: Faleminderit zonja Ademi! Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e komisionit? Po, zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Në qoftë se nuk gabo, kompetenca për caktimin e qendrave të votimit është e kryetarit të bashkisë, apo jo?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Po, në bazë të Kodit dhe një udhëzimi!

Z. I. Rusmali: Pse keni caktuar ato qendra votimi ju?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Sigurisht në kohën që ne i kemi përcaktuar atje nuk kishim bërë një verifikim dhe jemi në kushtet e organizimit të zgjedhjeve në një periudhë të shkurtër. Në momentin që u caktua data, ne automatikisht filluam procesimin, dhe në momentin e parë që ne kemi verifikuar, ne kemi kërkuar, në fakt i kemi dërguar informacion tabelar për të gjithë ato çfarë mungojnë dhe informacioni i është dhënë KQZ-së, Komisionerit në këtë rast, për mungesat që janë në ato qendra, dhe menjëherë kemi reflektuar duke i dërguar katër kërkesa për ndryshimin e atyre qendrave.

Z. I. Rusmali: Komisioneri thotë që ju nuk keni bërë propozim. Nuk keni bërë propozim për qendra.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Ne kemi bërë një propozim.

Z. I. Rusmali: Komisioneri që lexova unë, thotë “bashkia nuk propozon, apo për objektet private nuk propozon”.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Ne e kemi marrë angazhimin, ne e kemi thënë disa herë që nuk, nuk, nuk... Atëherë sigurisht mendoj që pavarësisht se mund të jetë përtej kompetencës, mund të merren në konsideratë, apo mund të mos merren në konsideratë, unë si kryetare bashkie kam gjykuar që mund t'i jap disa mundësi Komisionerit, pastaj është në vlerësimin e të gjithë atyre për ta bërë këtë në territor. Ai është ai objekt, thashë njëherë, nuk ka fare rëndësi. Mund të jetë çfarëdo lloj objekti, kjo për ne nuk ka fare rëndësi, por mjafton që të bëhet në një territor që është i sigurt dhe i aksesueshëm nga zgjedhësit.

Z. I. Rusmali: Zgjedhësit sipas ligjit votojnë atje ku kanë vendbanimin. Ju na thatë neve që zgjedhësit e këtyre zonave vetëm verojnë atje, por dimërimin e kalojnë në Shkodër. Pse nuk u keni ndryshuar vendbanimin këtyre zgjedhësve, t'ua bëni në Shkodër?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Nuk është ashtu sikurse ju e thatë. Ata banojnë në njësitë administrative Shalë, Shosh dhe Pult dhe dimërojnë në Shkodër. Kthehen në vendbanimet e tyre gjatë fundit të muajit mars, në varësi të motit, fillim prilli dhe vazhdojnë të banojnë atje. Kuptohet ata lëvizin gjatë gjithë kohës, bëjnë produktet e veta, hapin shtëpitë, i riparojnë, hapin edhe rrugët bashkë me ne, mbjellin dhe mbledhin të gjitha frutat, edhe të pyllit. Kjo ndodh deri diku nga mesi i muajit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

tetor, fund tetori po qe mirë, nëntor fillojmë e mbyllemi edhe njëherë në Shkodër, që do të thotë që ata janë, e kanë vendbanimin atje. Kjo është e para.

Z. I. Rusmali: Domethënë u ndamë barazim kryetare. Unë thashë për verimin, ju thatë për dimërimin.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Unë dimërimin e thashë që në momentin e parë.

Z. I. Rusmali: Ju folët për 6 muaj, unë fola për 6 muaj. U ndamë barazim, vetëm ndërruam stinët.


Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Një minutë të lutem! Ta mbaroj pak! Vendbanimi i qytetarëve nuk përcaktohet nga kryetaria e bashkisë, as nga bashkia. E drejta për të vendbanuar përcaktohet nga vetë individi. Askush nuk ka të drejtën t'ia ndryshojë vendbanimin dikujt pa e kërkuar dhe pa miratim. Në këtë rast, të gjithë banorët që kanë kërkuar ndryshimin e vendbanimit, dhe ka të tillë, ne kemi bërë procedurat përkatëse sikurse ligji e parashikon.

Z. I. Rusmali: Dhe këta banorë janë në listën e zgjedhësve, në vendbanimin...

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Për ata që janë, janë në qendra të ndryshme ata që kanë ndryshuar gjatë viteve.

Z. I. Rusmali: Ata që kanë kërkuar ndryshim vendbanimi, janë aty ku kanë vendbanimin sot.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Voltana Ademi ka ndryshuar shtëpinë dhe vendbanimin. Po unë kam shtëpi dhe në Shkodër, por kam dhe në Tiranë.

Z. I. Rusmali: Ne jse se nuk po diskutojmë doktrinën e vendbanimit, nuk është çështje e jona. Gjatë periudhës nga dekretimi i këtyre zgjedhjeve e deri sot, banorët e këtyre zonave, keni pasur kërkesa për ndryshim vendbanimi?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Sigurisht!

Z. I. Rusmali: I keni listuar ato?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Kur flas për kërkesat, flas për kërkesa në formën formale, por unë kam kontakte të përditshme. Mbase ndoshta nuk ka kohë që kjo trupë t'i vlerësojë në territor, se nuk kemi kohë, por mendoj që po t'i pyesnit që të gjithë, askush nuk do donte të merrte rrugën në atë ekstrem për të shkuar, jo për të votuar, që kërkon një angazhim, sigurisht edhe vullnet, por as për të parë shtëpinë e vet.

Z. I. Rusmali: Domethënë nuk ka pasur kërkesa nga ata për të ndërruar vendbanimin për të ardhur në Shkodër?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Unë kam minimalisht dy kërkesa në qoftë se ata janë dy qytetarë. Ata janë personazhe politike, por janë dy qytetarë, në fakt që banojnë në ato dy zona dhe i kam dhe me vete.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Z. I. Rusmali: Një pyetje, se kjo është shumë ligjore. Besoj që të gjitha palët e përfshira janë të bindura për faktin, e para, ligji i regjistron zgjedhësit në qendrën e votimit të vendbanimit të tyre dhe vendbanimi është kategori juridike, e dyta, qendra e votimit nuk lëviz jashtë njësisë, domethënë nuk lëviz jashtë zonës së qendrës së votimit, me përjashtim të rasteve përjashtimore, kur mund, për rrethana specifike, pra për mungesë, mund të lëvizë në zonën *limitrophe*. Këto janë kushte ligjore. Kërkesa që i ka ardhur Komisionerit, po vjen automatikisht edhe tek ne, kërkon që këto kushte ligjore të mos merren në konsideratë. Pyetja që kam unë është, ju e konsideroni KAS-in kompetent që të modifikojë ligjin deri në këtë pikë?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Për sa e njoh unë Kodin Zgjedhor, nuk jam juriste. E them këtë si parashtrim se mendoj që duhet të merret në konsideratë. Ne kemi adresuar çështjen tek Komisioneri që është autoriteti i parë, që ka detyrën të marrë një vendim për kushtet për të cilat ju folët, sapo folët.

Z. I. Rusmali: Ka ai kompetencën të lëvizë ligjin deri në këtë pikë?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: E thotë Kodi Zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Çfarë thotë?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Kodi Zgjedhor thotë, neni 62, pika 4, po e lexoj “Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit, kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve”. Nuk jemi në

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

ato kushte prapëseprapë “përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ”.

Z. I. Rusmali: Po, pra! Po kush janë kushtet kur ndryshon?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Për shkak të forcave madhore.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”: Kushti është mosaksesueshmëria, mosdhënia e së drejtës së votës.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jua garantoj unë që do ketë dy metër borë, mos dy, 80 cm borë, në një zonë që është kështu...(me foto)

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”: I kemi me foto të gjitha.

Z. E. Çefa: Pra, praktikisht atje nuk do bëhen zgjedhje apo jo, se nuk shkojnë as materialet zgjedhore normal?

Znj. V. Ademi, kryetare e Bashkisë Shkodër: Atëherë, kur i thashë unë një administratorit tim, që është Tom Marku, po ia përmend dhe emrin, burrë shumë i mirë, nga Pulti. Pulti është më afër se të shkosh në Shosh, se të hipësh në mal të Shoshit është më e tmerrshme sesa në Pult. Pulti është një orë larg, që është qendra më e afërt Kiri. Në Kir, Bruçaj, situata është kështu (foto), nuk ka rrugë, sepse çfarë bëjmë, ne në pranverë hapim të gjitha rrugët nga fillimi. Tani, ideja është që kjo është data 27 dhe nuk po flasim për rrugën që përshkojnë qendrën, por do shkojmë nga qendra do shkojmë në Bruçaj, prej qendrës do shkojmë në Pog, prej qendrës në

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Kir. Në Kir vetëm mund ta kemi aksesin më të mirë, por prapë është i vështirë, sepse para se të shkojmë në Kir, kemi tri kthesa që kalojnë tre burime dhe është akull. Gjashtë herë në vit shkoj unë atje.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Mundem zoti Rusmali të ndërhyj për diçka?

Z. I. Rusmali: Po patjetër!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Meqë është në lidhur me pyetjen tuaj. Ne normalisht kemi ankimuar dhe unë në këtë cilësi në fakt ndaj palës së interesuar, kam ankimuar vendimin nr.116 që është marrë në datën 2 mars, për mosdhënien e autorizimit. Ndërkohë që vendimi nr. 114 i datës 1 mars kërkohet autorizimi për ndryshimin e një QV-je, po nga Bashkia Shkodër dhe prapë dhe në këtë rast jepet autorizimi. Ku është këtu ndryshimi midis pyetjes që i bëtë ju zonjës Ademi, të elementeve të ligjit që ju thoni, dhe një vendimmarrjeje me dy standarde. Kemi 114-ën, që thotë "po, jepet autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0272, 0272/1.

Z. E. Lako: Dy standarde bëhet fjalë për QV të ndryshme? Sepse duhet parë tani ajo, sepse ajo bëhet nga verifikimi në vend, nuk është dy standarde.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo, pavarësisht zoti Lako.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo, në aspektin formal procedural.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

Z. E. Lako: Dy standarde kur kemi të bëjmë, se mund të na thotë dhe përfaqësuesi, zoti Sekretar i Përgjithshëm.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Flasim për aspektin e ligjit, për çfarë është miratuar, ka parë forcë madhore Komisioneri që ka miratuar atë, dhe këtu s'ka pasur forcë madhore.

Z. E. Lako: Mirë ajo vlerësohet pra, se ka një procedurë ligji si vlerësohet.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Po pra, si vlerësohet?


Z. E. Lako: Ja të na e thotë si është vlerësuar në rastin konkret.

Z. I. Rusmali: Mos e bëjmë debat, nuk ka nevojë. Ju dhatë argumentin tuaj për bazën ligjore të kërkesës suaj dhe ju thoni që ky paragraf jep mundësinë që të modifikohet qendra e votimit edhe përtej kushteve, kushteve të ligjit.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Po, e kemi bërë!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Se ligjvënësi e lë të interpretueshme në rastin, domethënë të themi të garantimit të interesit maksimal nëpërmjet një force madhore. Ti i garanton interesin e votës, për shkak se kushtet klimaterike dhe objekti, vetë dje drejtori i OSHE-së, Shkodër ka dalë në konferencë ka thënë "unë s'kam priza atje". Në këto njësi që ne po kundërshtojmë sot dhe po kërkojmë vendosjen e tyre, thotë "unë s'kam priza". Ku do vihet PEI në atë rast? Si do

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 04.03.2022

funksionojë? Pavarësisht autonomisë që mund të ketë dhe vetë anëtarët e QV-së për këto QV, në të 12 QV-të.

Z. I. Rusmali: Në qoftë se të gjithë drejtorët rajonalë të KESH-it mblidhen bashkë, dhe në mbledhjen e përgjithshme të organizatës që do të vendosin që të ndërpresin energjinë elektrike ditën e zgjedhjeve, dhe ne jua legjitimojmë këtë gjë. Nuk të duket sikur e zhveshim ca Presidentin e Republikës nga kompetenca e vet për të caktuar datën e zgjedhjeve? Ia kalojmë drejtorit të KESH-it dhe organizatës?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo, por pavarësisht të gjitha këtyre kjo është përgjegjësi penale, dhe është personale, i nderuar...

Z. I. Rusmali: Institucionet publike kanë detyrën, nuk kanë tagrin. Nuk është tagër, por është detyrë. Në qoftë se drejtori i KESH-it, i Shkodrës, thotë s'kam priza, detyra e tij është të bëhet vetë prizë, dhe të garantojë energjinë elektrike. Nuk është "shtyni zgjedhjet se unë s'kam priza".

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jam shumë dakord!

Z. I. Rusmali: Kështu që të lutem mos ma bëj drejtorin e KESH-it forcë madhore, se nuk e gëlltis dot.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo unë e bëj për shkak se nuk garantohet procesi. Po e bëj se nuk garantohet energji elektrike.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

Z. I. Rusmali: Drejtori i KESH-it garanton procesin. Ai ose garanton procesin ose lë çelësat. Kështu është logjika institucionale. E garanton një tjetër mbas teje që ky është i zoti. Detyra e institucioneve është të garantojnë funksionueshmërinë e qendrave të votimit të të gjitha institucioneve të përfshira dhe nuk ka diskutime për këtë. Diskutimin e kemi juridik. Kemi një dispozitë që thoni mbështet kërkesën tonë. Ne do ta gjykojmë, pastaj është kjo që e mbështet kërkesën tonë, apo mbështet gjë tjetër kjo..., se mund të jetë dhe që mbështet diçka tjetër.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: A mund të shtoj dhe diçka?

Z. I. Rusmali: Po, patjetër!

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Ne kemi ndryshuar disa qendra votimi që nuk kanë ardhur si rrjedhojë e propozimit, në fakt të Bashkisë Shkodër, por kanë ardhur si rrjedhojë e një kërkesë që palët, po themi politike, kanë bërë pranë KZAZ-ve. Ato kanë ardhur tek ne, KZAZ-ja vetë, dhe ne i kemi thënë patjetër. Është ky objekt, s'është ky objekt, për ne është njësoj.

Z. I. Rusmali: Por, nuk besoj se po kërkon vlerësimin tonë.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo për shkaqe më madhore, por për shkaqe pëlqesash, Komisioneri, apo vullnetesh të forcave politike për qejf, kemi hequr prej këtu, e kemi vendosur këtu, dhe Komisioneri ka marrë një vendim të tillë.

Z. I. Rusmali: Kryetare, më the që ky paragraf mbron kërkesën time për shkaqe madhore, mund të bëhet, them unë.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Është shkak madhor, për mendimin tim.

Z. I. Rusmali: Tani nuk është në favor të vendimit tënd fakti që për pëlqesa u bë.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo, por nuk thashë në favor timin, po pra nuk është...

Z. I. Rusmali: Ke një rast madhor. Këtë ta konfrontojmë, sepse ajo që lexojmë ne mund të jetë e ndryshme nga ajo që lexoni ju.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Ajo që u përgjigja unë pyetjes suaj, dua të dal tek përgjigja e pyetjes suaj, Komisioneri ka ushtruar duke e quajtur shkak madhor, se nuk gjej arsyetim tjetër unë tani, edhe ndryshimin e qendrës së votimit për shkak të pëlqesës, se e ka bërë këtë, duhet të më japë argumentimin pse e ka marrë vendimin atëherë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Për çfarë në vendimin nr. 114 është vendosur autorizimi i vendosjes së qendrës së votimit?

Z. E. Çefa: A është brenda territorit të qendrës së votimit, është bërë zhvendosja apo jo?

Z. Y. Merkaj: Është brenda zonës.

Z. E. Çefa: Po tek 114?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Brenda zonës zgjedhore.

Z. Y. Merkaj: Është brenda zonës së qendrës së votimit, ka ndryshim.

Z. E. Çefa: Brenda zonës së qendrës së votimit, jo zonës zgjedhore. Po, pra, por nuk janë identike avokat.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo nuk ka elemente të tillë. Nuk është vetëm një rast që duhet të përmbushet, duhet të përmbushen shumë. Rasti i forcës madhore, është rast force madhore, zoti Çefa, ju e dini tani. Janë 5 mijë e disa zgjedhës në të tria këto njësi administrative.

Z. L. Braho: Sa janë që dimërojnë tek këto, pra që ndodhen aktualisht?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: 204 vetë ke në të gjithë malet sot, përjashtohet Thethi.

Z. L. Braho: Po në qoftë se, marrim rastin hipotetik që këta spostohen, spostohen qendrat e votimit? Po këtyre do ja mohojmë të drejtën e votës, këtyre 204-ve?

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo, nuk e thashë unë këtë. Unë nuk thashë, aty qarkullohet, me helikopter.

Z. L. Braho: Dhe bashkia do vërë helikopter për këta 204?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: A jemi shteti që duam t'i sigurojmë zgjedhësit të drejtën e votimit?

Z. E. Lako: Tani meqë u hap ky debat unë them që ka nevojë dhe për një sqarim këtu nga administrata, që ky është një proces që ju keni ardhur sot në KAS. Jemi 2 ditë para zgjedhjeve, dhe prisni nga KAS-i që të gjejë ca qendra votimi të përshtatshme. Unë them që ky është një proces që ligji e ka përcaktuar si bëhet. Domethënë ka një rrugë të gjatë që vjen nga bashkia në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se këto janë probleme që nuk dolën sot. Ju duhet ta dini besoj, që në kohë dimri ka vështirësi qarkullimi në rrugë dhe duhet ta kishit pasur parasysh këtë fakt dhe nuk e di si është zgjidhur...

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Po unë nuk e di kur i dekreton zgjedhjet Presidenti. Këtë nuk e di unë.

Z. E. Lako: Jo, si është zgjidhur me administratën. Nga administrata këto gjëra që po diskutojmë sot këtu, si i keni zgjidhur, të Komisionerit?

Z. I. Rusmali: Edhe në vazhdim të asaj që tha Elvini, që ta kompletoj dhe pastaj të na japin përgjigjen. Në KAS vihet për t'u ankuar për veprime të paligjshme të Komisionerit, jo për të gjetur zgjidhje. Zgjidhjet i gjen Komisioneri bashkë me subjektet, a si i kanë rregullat ata. Ne mobilizohemi kur Komisioneri shkel ligjin, dhe ju duhet të na thoni që Komisioneri ka shkelur ligjin, dhe ne të themi e ka shkelur apo s'e ka shkelur. Tani të na japin përgjigjen.

Z. E. Lako: Nuk mund të gjejmë ne sot këtu qendra votimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo, nuk e kemi thënë këtë!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Është bërë propozimi zoti Lako!

Z. E. Lako: Ky është një problem që pushteti vendor me KQZ-në duhet ta kishte zgjidhur këtë punë. Domethënë, propozimi mund të bëhet sot, por ti e di shumë mirë që ka ca afate ligji, që kur përcaktohet qendra e votimit, merren masat që këto qendra të jenë funksionale, shpallen listat e zgjedhësve. Domethënë ka një sërë procesesh ligji, nuk është një gjë, që ajo qendra e votimit, e thamë ne këtu dhe u bë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jam shumë dakord! Propozimi për caktimin e qendrave të reja është dhënë.

Z. E. Lako: Qëllimi i të gjithëve është që të krijohet mundësia e zgjedhësve që të votojnë, por në përputhje me kushtet dhe kriteret ligjore. Në qoftë se ligji përcakton që zgjedhësi duhet të votojë atje ku ka qendrën e vendbanimit, kjo është pasur parasysh nga ligjvënësi kur e ka shkruar normën. Ne duhet të bëjmë, ne, po flas të gjithë aktorët, duhet të bëjmë të mundur që kjo e drejtë e zgjedhësit t'i krijohet. Pra, mund të bjerë borë nesër edhe në mes të Tiranës, të bllokohen rrugët, tani ne do themi që këto qendrat e votimit të gjithë Shqipërisë do i bëjmë në Sarandë, që s'bie borë? Këto gjëra duhet të jenë të parashikuara, prandaj dua dy fjalë nga administrata që si e ka menduar, ka bërë ndonjë verifikim në vend, ka mundësi të zhvillohen zgjedhjet aty, ka pasur ndonjë mundësi ku mund të zhvillohen diku tjetër? Nuk e di, sepse ne s'mundet të bëjmë hetim tani.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Po, pra po, se kur gjykon bazuar në nenin 62, pika 4, ajo fillon e lexohet nga fillimi deri në fund. Dhe në qoftë se ka për të zbatuar vendimin, nenin 62, pika 4, unë mendoj që nuk e ka zbatuar.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, Kodi Zgjedhor aktual nuk parashikon që qendrat e votimit të lëvizin, por parashikon që zgjedhësi duhet të shkojë tek kjo qendër votimi, që është caktuar. Ne në praktikën tonë kemi pasur shumë herë që kemi ndryshuar qendrën e votimit, por gjithmonë duke respektuar nenin 62 të Kodit Zgjedhor, që qendra e votimit do ndryshojë brenda hartës së zonës zgjedhore, e cila është në njësinë gjeografike me kompakt të pandarë, ose në vetëm një rast ka që mund të lëvizë qendra e votimit, në një zonë fqinje. Vetëm për ambientet private. Zonë zgjedhore fqinje.

Z. I. Rusmali: Po, zonë qendre votimi fqinje.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo, zonë zgjedhore kush quhet në zgjedhjet vendore?

Z. Y. Merkaj: Zonë e qendrës së votimit.

Z. I. Rusmali: Në zonë qendre votimi fqinje, *limitrophe*.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": *Limitrophe* është njësi që është propozuar njësi...

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.04.03.2022*

Z. Y. Merkaj: Jo, zona e qendrës së votimit është kjo, për shembull, dy-tre pallate janë këtu afër, dhe këto tre pallate janë njësi gjeografike, të cilat kanë një qendër votimi aty afër, zona tjetër mund të jetë dy-tre pallate të tjera. Këto janë në zonën e qendrës së votimit. Jo të kalojë 50, 60 kilometra..

Z. E. Lako: Në rastin konkret, si është zgjidhur nga KQZ-ja? Domethënë është bërë një verifikim, është quajtur normale, do bëhet votim ditën e votimit në këto qendra? Se kjo duhet të na interesojë, a do votojnë njerëzit, a do hapen këto qendra votimi, a do shkojë baza materiale? Pra, është bërë një hetim nga KQZ-ja, për QV po flasim në objekt gjykimi, se ato të tjerat i kemi zgjidhur.

Z. Y. Merkaj: Deri para ndryshimit të Kodit Zgjedhor që ndryshon periudha zgjedhore, zgjedhjet zakonisht kanë rënë në periudhë pranvere ose vere, dhe s'ka pasur borë. Në këtë rast KQZ-ja e ka çuar bazën materiale te KZAZ-ja, e cila ka qendrën në Shkodër dhe KZAZ-ja do ta çojë në qendrat e votimit, në Shosh, në Pult dhe në Shalë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Jo, ZAZ-ja ka dhënë përgjigje dhe kërkon që të zhvendosen ato për shkak të kushteve atmosferike. E keni aty përgjigjen.

Z. Y. Merkaj: Kodi zgjedhor nuk e autorizon dhe nuk e parashikon që të lëvizin qendrat e votimit kaq larg. Qendrat e votimit vetëm në një rast, kur ka qendër...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Përkufizimet. Zona e qendrës së votimit është një zonë brenda territorit të një bashkie ose zone zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. Y. Merkaçaj: Domethënë, brenda të një territori të një bashkie, është Bashkia Shkodër, ka 250 zona të qendrës së votimit.

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Dhe s' duhet të jetë më shumë se 5 mijë metër.

Z. L. Braho: Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Më fal, përkufizimet e ligjvënësit janë të qarta.

Z. I. Rusmali: Tek zhvendosja e qendrës së votimit, rasti përjashtimor parashikon zhvendosjen tek zona e qendrës së votimit ngjitur.


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Po, pra komuna "Rrethina" është ngjitur.

Z. I. Rusmali: Jo njësi administrative, zona e qendrës së votimit ngjitur.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L": Por, nuk ka aksesueshmëri atje, zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Qendra e votimit 0001 mund të shkojë, edhe ajo ka zonën e vet, mund të shkojë dhe të zhvendoset tek 0002.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.04.03.2022

Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër: Jo, mund të shkojë dhe tek 118-ta që është e njëjta zonë zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Jo, jo! Tek zona e qendrës së votimit ngjitur... (me vizatim)

Z. E. Lako: Ka ndonjë koment tjetër, ndonjë pyetje? Nuk ka! Atëherë tërhiqemi për vendim.

Rifillon seanca

Ora 12:11

Atëherë çelim seancën, dhe KAS-i pasi u këshillua, vendosi që këtë çështje ta kalojë për shqyrtim, dhe seancën për kalimin e çështjes për shqyrtim do ta riçelim në orën 13:00 të ditës së sotme, për shkak të emergjencës që ka kjo çështje, sepse zakonisht ne në rregullore e kemi që duhet të kalojë 24 orë nga shqyrtimi i çështjes paraprake. Kështu që në orën 13:00, sot do të rimblidhemi edhe njëherë për ta gjykuar në themel. Faleminderit!

Vendim nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

